

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	'Siguria në shkolla nuk negociohet', 4 ministri bashkojnë forcat për fëmijët! Demo: Zero tolerancë për çdo veprim që i vë në rrezik - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/siguria-ne-shkolla-nuk-negociohet-4-ministri-bashkojne-forca-t-per-femijet-demo-zero-tolerance-per-cdo-veprim-qe-i-ve-ne-rrezik
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 16:08:44 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 16:06:50 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	03424395875bf35ffd44687550d4adc891b9dc42c5f23807559184800dacf64c
TEKSTI	c61128a225101bae509c8bd53b0032607836f1e41ed6fbcbaa3f1e27179af7d4
PAMJA	f4c78a5a7debd5501fc47b89478c2166e413cd9a56939db4831e75bc91aadae0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b57d0657e3c7a7cb046b220dfac7ab12a0d4eb0489a8cf797ff033194882b7f3
E MËPARSHMJA	a996dceda86968fa53009a5d9df13ebc3cb8edd70225b9de34048bfd74cf85eb
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/b57d0657e3c7a7cb046b220dfac7ab12a0d4eb0489a8cf797ff033194882b7f3

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



San Marino-Shqipëri, formacionet zyrtare/ Rikthehet Mitaj, Sina debutojnë me kuqezinjtë! Ndryshime nga porta në sulm



Sociale

'Siguria në shkolla nuk negociohet', 4 ministri bashkojnë forcat për fëmijët! Demo: Zero tolerancë për çdo veprim që i vë në rrezik

Ervin Demo, Mirela Kumbaro, Klodiana Spahiu dhe Andis Salla prezantuan ndarjen e përgjegjësisë mes katër ministrave për sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve.



Mirela Kumbaro, Ervin Demo dhe Klodiana Spahiu



Redaksia

29 Shtator, 18:02 | Përditësimi: 29 Shtator, 18:54

Share Tweet

A A

Nga siguria brenda dhe jashtë shkollës, te kujdesi për shëndetin dhe ushqimi, katër ministri do të bashkërendojnë punën për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve. Paketa Kombëtare e Sigurisë në Shkollë u prezantua këtë të martë në Kamëz, në një takim me nxënës, mësues dhe prindër.

Në takim ishin ministri i Punëve të Brendshme, [Ervin Demo](#), ministria e Arsimit, [Mirela Kumbaro](#), ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, [Klodiana Spahiu](#), ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, si dhe kryetari i Bashkisë Kamëz, Rakip Suli.

Katër ministritë do të kenë role të ndryshme në këtë paketë. Policia e Shtetit do të angazhohet për mbrojtjen e fëmijëve, Ministria e Arsimit për mirëqenien dhe sigurinë brenda ambienteve të shkollave, Ministria e Shëndetësisë për kujdesin dhe mirëqenien, ndërsa Ministria e Bujqësisë për sigurinë ushqimore.



LEXO EDHE:

Rama propozon krijimin e Këshillit Kombëtar për fëmijët me aftësi ndryshe: Fuqizim i sistemit të mësuesve ndihmës dhe mbështetje ekstra financiare (VIDEO)

Ministria e Arsimit, Mirela Kumbaro, u ndal te roli që kanë brenda shkollave oficerët e sigurisë, psikologët dhe punonjësit socialë, ndërsa theksoi se katër ministritë po ndajnë mes tyre përgjegjësitë për të krijuar një mjedis më të sigurt për nxënësit.



"Nuk ia dalim dot vetëm. Ne jemi 4 ministra ku, pas një pune shumë të gjatë, po ndajmë së bashku detyrat e ministrave për të ofruar një mjedis sa më të shëndetshëm dhe të sigurt për



shkollën. Ky bashkërendim është i domosdoshëm edhe për t'u dhënë qetësi prindërve në momentin që i dërgojnë në shkollë, i kanë lënë në duart e institucioneve. Qoftë policia, qoftë sistemi që po instalojmë i kamerave inteligjente", tha Kumbaro.

Kumbaro informoi se në rreth 20 shkolla në Kamëz dhe Tiranë është instaluar sistemi i kamerave inteligjente, ndërsa në pjesën tjetër të shkollave funksionon rrjeti i kamerave tradicionale.

Sipas saj, të gjitha këto masa, të bashkërenduara, rrisin garancitë e sigurisë. Nga ana tjetër, ministri i Brendshëm, Ervin Demo, e vendosi theksin te roli i Policisë së Shtetit dhe siguria në perimetrin e shkollave.

"Ne jemi sot katër ministra në takim, që të ofrojmë një mbrojtje dhe siguri të plotë 360 gradë për fëmijët në vendin tonë", deklaroi Demo.

Ai tha se do të ketë "zero tolerancë" për aktet apo veprimet që mund të vënë në rrezik mirëqenien e fëmijëve, ndërsa sigurinë në shkolla e cilësoi si "vijën më të kuqe të mundshme" për Policinë e Shtetit.

"Ka zero tolerancë dhe është vija më e kuqe e mundshme që Policia e Shtetit tashmë ka vendosur për sa i përket garantimit të të gjithë atyre elementëve që duhet ta bëjnë një prind, një familje të qetë dhe mbi të gjitha të sigurt për të ardhmen e fëmijëve të tyre kur shkojnë në ambientet e shkollës", u shpreh ministri.

Ministria Spahiu u ndal edhe te rëndësia e shëndetit fizik dhe mendor të nxënësve.

"Nëse nuk gëzojmë një shëndet të mirë, nuk mund të jemi në çdo profesion të arrirë. Nëse nuk ka një shëndet mendor të mirë, nuk mund të japim një produktivitet të lartë", tha ajo.

Sipas saj, përgjegjësia e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale lidhet edhe me garantimin e kushteve të përshtatshme higjieno-sanitare në shkolla, përfshirë ujin e pijshëm sipas standardeve dhe pastërtinë.

Paketa e sigurisë në shkolla synon edhe parandalimin përmes bashkëpunimit mes oficerëve të sigurisë, psikologëve, mësuesve, policisë dhe prindërve, për të identifikuar në kohë fenomenet që mund të cenojnë sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve.

U.D/Shqiptarja.com

TAG: [siguria ne shkolla](#) [Mirela Kumbaro](#) [Klodiana Spahiu](#) [ervin demo](#)

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH
COM

Sondazhi i ditës:

26 Shtator, 18:15

Ambasadori i ri i SHBA nis misionin, a besoni se do sjellë ndryshim në mjedisin politik?

Po

Jo

Disi

Lajme të tjera



'Shteti i së drejtës, në qendër të rrugës drejt BE-së', ambasadorja e Bashkimit Europian zbardh takimin me Ervin Demon: Të vijojë lufta kundër krimit të organizuar

29 Shtator, 16:01



Kumbaro sqaron përdorimin e Inteligjencës Artificiale në shkolla: Nuk është me detyrim! Udhëzuesi tregon si të përdoret pa i bërë nxënësit dembelë

29 Shtator, 15:15



Jep dorëheqjen kreu i Fondit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, ja kush e zëvendëson

29 Shtator, 11:27





Ministria Spahiu mbledh drejtuesit e QSUT: Më shumë efikasitet në çdo hallkë, menaxhim i orientuar te pacienti

29 Shtator, 09:46



Demo pret Ambasadoren e BE-së: Bashkëpunim më i fortë për sigurinë dhe integrimin evropian

28 Shtator, 19:08



Operacioni i Policisë kundër shitjes së drogës në shkollat e Tiranës, Demo: Prioritet për sigurinë e fëmijëve tanë

27 Shtator, 09:13



Kombinat, vijon puna për familjet e prekura nga tërmeti i 2019-ës, ministri Demo: Rindërtimi duhet të ecë me ritëm, njerëzit kanë pritur mjaftueshëm (VIDEO)

26 Shtator, 15:13



Ministri Demo në 'Future Tech 2026': Identiteti biometrik, infrastrukturë kritike për sigurinë e shtetit

24 Shtator, 13:30



Ministria Spahiu kërkon forcimin e shërbimeve sociale: Të shkojnë aty ku janë nevojat e qytetarëve (VIDEO)

24 Shtator, 12:35



PD e akuzoi se nuk priti një qytetar të sëmurë, Spahiu publikon foton nga takimi: Mos bëni politikë me problemet shëndetësore

23 Shtator, 12:10



Shqipëria arrin objektivat europiane për kontrollin e hepatitit B, OBSH i dorëzon certifikatën Spahiut gjatë takimit me drejtuesin e ri

22 Shtator, 12:01



Spahiu viziton Onkohematologjinë Pediatrike në QSUT: Kujdes i specializuar dhe mbështetje për çdo fëmijë

21 Shtator, 17:39

[Kodi Etik](#)

[Kontakt](#)

[Rreth Nesh](#)

[Raportoni Ju](#)

[Puno me ne](#)

[Shqiptarja.com]

Kërko



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohej riprodhimi i paautorizuar i kësaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.